

Statuti i Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar BEA-Credit sh.p.k.

- Në këtë statut
- "Ligji" është Ligji Nr. dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";

"Statuti" është Statuti i shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1 : Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 30.10.2020 , thmeluesi, ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin BEA-Credit sh.p.k.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

- Znj. Bianka Ferruku, e lindur me date 12.09.1987 ne Tepelene, Shqiperi, banues ne adresen : Njesia Administrative Dajt, Zona Kadastrale Nr.2460, Nr.Pasurie 505/3 16+1-1 Rr.Baftjar Liçi, Linze, H. 1, AP. I , Tirane, Shqiperi, me shtetesi shqiptare, Me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasapoltes Nr. BF1453083 e leshuar ne date 13.05.2016

Neni 2: Objekti

. Aktivitet ne fushen bankare,kembime valutore,financiare,agjent per transfert parash,sherbime etj

Neni 3: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me kufi te pacaktuar .Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe per cfaredo shkaku me vendim te ortakeve.

Neni 4: **Selia**

(I) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:

TIRANE Njësia Bashkiakenr.5,Blv."Bajram Curri" , pallati 1 Maj , kati 1 ,apartamenti 1 ,Z.K. nr.8260,Nr.Pas. 5/32+8-7

Kreu II

Kapitali i Regjistruar

Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 2500.000 Lekë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

I . Ortaku themelues Bianka Ferruku, I (nje) kuote

Iloji i kontributit : cash dhe
vlera e kontributit ; 2500.000
Lekë; pjesa e zotërimit të
kapitalit të shoqërisë 100 %

Vlera totale e kapitalit te regjistruar : 2500.000 Leke (dy million e pese qind mij leke)

Vlera e paguar : 2500.000 Leke (dy million e pese qind mij leke)

(2) Kontributet ne para do të paguhen (plotësisht) menjëherë. Kontributet në natyrë do ti kaloinë Shoqërisë menjëherë pas regjistrimit në QKB.

(3) Pagesat e kontributeve në para do të kryhet në Illogarinë e shoqerise pranë Raiffeisen Bank, menjehere pas celjes se saj ne QKB.

Neni 6: Kërkesa për të paguar kuotat dhe térheqja e kuotave të papaguara

- (1) Administratorët mund t'u kërkojnë ortakëve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe cdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej *30* diteve kalendarike), në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikoi shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të lënpasshëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.
- (2) Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të lënesipërm.
- (3) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaje një interes mbi shumën e papaguar me një kamatëvonesë prej *1 0* % në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.
- (4) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratorët mund të njoftojnë paraprakisht të paktën *30* ditë kalendarike personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumat e mundshme shtesë të kaçnatëvonesës. Njoftimi do të përbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarimin se në rast mosbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.
- (5) Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Asamblese dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluara dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.
- (6) Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratorët konsiderojnë të përshtatshme.
- (7) Personi, kuota e te cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuotë por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë per të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatëvonesën e illogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.

Në përputhje me dispozitat e Ligiit dhe pa cënuar te drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizinët e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave së oftakëve, në përputhje me parashikimet e Nenit 87 të Ligjit 9901.

Neni 8: Certifikatat e kuotave

Secili ortak ka të drejtë përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë per kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gjëzojë cilësinë e letërës me vlerë.

Neni 9: Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave.

- 1 . Kuotat e kapitalit të një shoqerie me përgiegiësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit
- d) cdo menyre rastin e kalimit të kuotave me, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

(1) Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme në shunlincën e kualifikuar të votave të ortakëve.

(2) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së

Përgjithslune, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

Neni I I : Blerja e Kuotave te Veta

(1) Shoqëria mund të blej; kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, JO nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpérndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpérndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratorët lëshojnë një certifikatë të alftësisë paguese të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligiit, paditë mbi përgiegiësinë e shoqërisë mund të ngrihen në parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit "Per tregtaret dhe shoqeritet tregtare".

Kreu III

Asambleja e Përgjithshme

Neni 12: Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Admistratorët, me kërkesën e ortakëve, sipas Nenit 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërrnjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (email) drejtar cdo ortaku, përfshirë edhe përafaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet te pernibaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mblehdhje.

(3) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës I të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë (dakord, të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë).

Neni 13: Mbledhjet e Asaambles së Përgjithshme

(1) Asambleja e Përgjithshme merr vendinne të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumi te parashikuar nga nen 86 i Ligiit. Ortakët ose përfaqësuesit e autori zuar n'luncit të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conférence cal/), audio ose audiovideo, në përputhje me nenin 88 të Ligiit. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë dre.itl: të votojnC nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njofitën për mbledhjen e Asaamblesë I)ërgjithshme.

- (2) Administratorët caktuinë Kryetarin e mbledhies si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
- (3) **Nëse asnë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëseasnë prej Administratorëve nuk është i pranishem përmbldhjetë nlinuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishënn dhe Ilie tē drejtëzgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.**
- (4) Administratori, pavarësisht se [Illk ësh(ç)n, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fialën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshnë.
- (5) Kryetari, me pëlqinlin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligi, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në III bledhien e dytë mund të diskutohen vetëm ato cështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do IC isllte slit} mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet, njoftimi do ti dergohet ortakeve jo me vone se shtatë ditë përpresa dates se caktuar dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes dhe përshtrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Ne rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshmme.
- (6) Asambleja vodos me votim te hapur me perjashtim te rastit kur perpara ose gjate deklarimit te rezultatit, nuk kerkohet ne menyren e duhur nje votim i fshehte. Votimi i fshehte mund te kerkohet nga:

I .Kryetari; ose

2. nje ortak ose ortaket qe perfaqesojne te pakten pese per qind te kapitalit themeltar te shoqerise. Kerkesa e bere nga nje perfaquesues i autorizuar i ortakut ka te njeften vlore me kerkesen e paraqitur nga vete ortaku.

(7) Me perjashtim te kundershtimit një ortaku, deklarimi i Kryetarit se vendimi eshte marre në menyre unanime, ose me nje shumice te caktuar, nuk eshte miratuar ose nuk eshte miratuar me nje shumice te caktuar dhe regjistrimi perkates ne procesverbalin e mbledhjes prben prove perfundimtare të ketij fakti, pa pasur nevoje per numerimin e votave te regjistruara pro ose kunder vendimit.

(8) Ne rast se ka kundershime per kete deklarate, do te zhvillohet nje votim i fshehte ne lidhje me percaktimin e numrit te votave pro dhe kunder vendimit.

Neni 14:

Votat e Ortakeve

(1) Ne perputhje me te drejtat ose kufizimet qe rrjedhin nga kuotat, cdo kuote i jep ortakut (ne rastin kur eshte individ) te pranishem apo perfaquesuesit te tij te autorizuar ose ortakut (ne rastin kur eshte person juridik) i cili eshte i pranishem permes perfaquesuesit ligjor apo perfaquesuesit te autorizuar ne menyre te rregullt, te drejten e nje vote.

(2) Cdo kundershtim ne kohe per cilesine e nje votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi i te cilit do te jete perfundimtar.

Neni 15:

Votimi me Prokure

(1) Perfaquesuesi do te emerohet nga ortaku sipas formes se meposhtme (ose ne formen e zakonshme apo formen qe mund te miratohet nga Administratoret):

BEA-Credit sh.p.k.

Une / Ne i / te nenshkruari / ... , ne cilesine e ortakut / ortakeve te shoqerise se lartpermendur, emeroj /ose ne pamundesi te tij, . ne cilesine e perfaquesuesit / vetim / tone per të votuar në emer / emrat tim / tone dhe ne Ilogariné time / tone në mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te shoqerise e cila do te mbahet më *data / muaii / viti* dhe ne cdo mbledhje te shtyre.

Nenshkruar me *data / muaii / viti*.

(2) Ne rastet kur deshirohet tu jepet ortakeve mundesia per te udhezuar perfaquesuesin per menyren veprimit, caktimi i perfaquesuesit behet sipas formes se meposhtme (ose ne formen e zakonshme apo formen qe mund te miratohet nga Administratoret).

BEA-Credit sh.p.k.

Une / Ne i / te nenshkruari / t, , ne cilesine e ortakut / ortakeve te shoqerise se lartpermendur, emeroj / me ose ne pamundesi te tij,..... ne cilesine e perfaquesuesit / ve tim / tone per te votuar ne emer / emrat tim / tone dhe ne Ilogarine time / tone ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te shoqerise e cila do te mbahet me *data / muaji / viti* dhe ne cdo mbledhje te shtyre.Kjo forme do te perdoret per vendimet e permendura me poshte:

Vendimi Nr. 1 *pro *kunder

Vendimi Nr. 2 *pro *kunder.

Pervec udhezimeve te tjera, perfaquesuesi mund te votoje ose abstenije, sic e quan te arsyeshme. Nenshkruar me *data/ muaii / viti*

(3) Caktimi me shkrim i perfaquesuesit ose nje kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratoret depozitohet ne seline e shoqerise ose ne nje vend tjeter brenda territorit te Republikes se Shqiperise,sic percaktohet ne njoftimin per mbledhjen e Asamblese së Pergjithshme ose ne ftesen per te caktuar nje perfaquesues te derguar nga shoqeria ne lidhje me mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme. Akti i emerimit te perfaquesuesit duhet te depozitohet jo me vone se 48 ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre, ne te cilen duhet te votoje perfaquesuesi.

(4)Ne rast se akti i emerimit te perfaquesuesit jepet nepermjet komunikimit elektronik te derguar ne adresen elektronike (*email*) sipas percaktiveve te pikes 3 te nenit 4 ,te ketij Statuti, ky akt duhet te merret jo me vone se 48 ore perpara ores se mbledhjes ose mbledhjes se shtyre ne te cilen duhet te votoje perfaquesuesi.

(1) Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

(2) Kur ortaku perfaqeshet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jetë ne te njejtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 17: Hetimet e posaqme

Personi ose personat qe plotesojne kushtet per te kerkuar emerimin apo zevendesimin e nje eksperti te fushes sipas nenit 91 te Ligjit paraqesin nje kerkese te tille nepermjet depozitimit te nje deklarate notoriale ne seline e shoquerise e cila verteton se personi ose personat plotesojne kushtet per kryerjen e ketij veprimi.

Kreu IV

Administratoret

Neni 18: Emerimi i Administratoreve

(1) Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoquerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riperteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren kombetare te Regjistrimit.


(2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit ti Nenit 207 te Ligjit 9901, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

(3) Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoquerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

Te dhenat e identifikimit:

(mbiemrat, emrat, adresat):

- Bianka Ferruku



dhe specimenet e nenshkrimit:

(4) Administratori Bianka Ferruku do te caktohet si Kryetare e mbledhjeve te Administratoreve deri ne zgjedhjen nga mbledhia e pare e zakonshme.

Neni 19:

Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te giitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e per gjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- q) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;
- d) krijojne nie sistem paralajmrimi ne kohen e dihir per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise•,
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Konobetare te Regjistrimit•,
- e) raportojne perpara asamblese se per gjithshnne ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaqme me rendesi te vegante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- é) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligi dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane një vlerë me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te

certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlore me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine. Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 20: **Perfaqesimi**

(1) Kufizimet e tagrave te perfaqesimit te administratoreve i kundrejtohen paleve te treta, ne perputhje me dispozitat e nenit 12 te Ligjit 9901.

(2) Administratoriet, qe perfaqesojne bashkerisht shoqerine tregtare, mund te autorizojne disa prej tyre Per kryerjen e disa veprimeve te caktuara apo per kryerjen e disa kategorive te caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratoreve jane te vlefshme e detyruese Per shoqerine.

(3) Tagrat e perfaqesimit te administratoreve dhe qdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrit.

Neni 21: **Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratoreve**

Detyra e Administratorit perfundon ne rast se:

- I . personi nuk eshte me Administrator sipas parashikimeve te Ligjit perfshire edhe parashikimet e pikes 6 te Nenit 95 te Ligjit "Per tregtaret dhe shqoerite tregtare";
2. personi ndodhet ne gjendje paaftesie paguese;
3. personi vuajt Ose mund te vuaje nga grregullime mendore;
4. personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqerine, ose
5. ka munguar per me shume se gjashte muaj radhazi pa lejen e Administratoreve te tjere ne mbledhjet e Administratoreve te mbajtura gjate kesaj periudhe dhe Asambleja e Pergjithshme, me propozimin e Administratoreve, vendos ta shkarkoje nga detyra.

Neni 22: **Shperblimi, Perfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratoreve**

(1) Administratorét shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me parashikimet e Nenit 97 te Ligjt "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

(2) Asambleja e Pergjithshme mund te parashikoje perfitime, nepermjet shperblimeve ne para, pensione, sigurime ose forma te tjera, per cdo person i cili ka qene por nuk eshte me ne detyre apo i punesuar ne shoqeri, shoqeri te tjera te cilat jane ose kane qene shoqeri te kontrolluara ose per shoqeri paraardhese te shoqerise ekzistuese ose te filialeve te saj, ose per cdo familjar te tyre (perfshire bashkeshortin/en, ish-bashkeshortin/en) Ose persona te cilet jane ose ishin ne varesi te tyre, dhe mund te paguaje kontribute ne fonde te caktuara per dhenien e perfitimeve te tilla.

(3) Administratoreve mund t'iua paguhen te gjitha shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesemarrjen e tyre ne mbledhjet e Administratoreve ose te komitetete te Administratoreve ose te Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me perm bushjen e detyrave te tyre.

Neni 23: Mbledhjet e Administratoreve

(1) Mbledhjet e Adlilinistratoreve do te mbahen sipas nevojave te aktivitetit tregtar te shoqerise.

(2) Asambleja e Pergjithshme cakton njerin prej Administratoreve me detyren e Kryetarit te mbiedhjes se Administratoreve, i cili mund te shkarkohet ne cdo kohe nga kjo detyre. Kryetari do te drejoje qdo mbledhje te Administratoreve ne te cilat ai eshte i pranishem, Ne rast se Kryetari nuk deshiron te drejoje mbledhjen apo nuk eshte i pranishem brenda pese minutave nga ora e caktuar per mbledhjen, Administratoret e pranishem mund te emerojne njerin prej tyre si Kryetar te

mbledhjes.

(3) Ceshtjet e rendit te dites vendosen me shumicen e votave te pjesemarresve. Ne rast numri te barabarte votash, vota e Kryetarit do te jete vendimtare.

(4) Te gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratoreve, ose nga një komitet i Administratoreve, apo nga persona te cilet veprojne si Administratore, pavaresisht nese behet e ditur me vone se ka pasur mangesi ne emerimin e një Administratori ose njeri prej tyre ka qene i skualifikuar nga mbajtja e kesaj detyre, ose nuk kishin te drejte te votonin, do te konsiderohen te vlefshme njelloj sikur keta persona te ishin emeruar rregullisht dhe te ishin cilesuar e te vazhdonin detyren si Administratore dhe te kishin te drejte te votonin ne mbledhje.

(5) Vendimi me shkrim i nenshkuar nga te gjithe Administratoret qe kane te drejte te njoftohen Per mbledhjen e Administratoreve ose nga komiteti i Administratoreve do te konsiderohet si i vlefshem dhe i efektshem njelloj si te ishte miratuar ne mbledhjen e Administratoreve, e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

Neni 24:

Kufizimet ne Votimet e Administratoreve

(1) Administratoret nuk do te lidhin marreveshje ose votojne ne mbledhjen e Adnninistratoreve per ceshtje ne te cilin keta anetare kane, direkt ose indirekt, nje interes apo detyrim i cili eshte material, qe eshte apo mund te jete ne kundershtim me interesat e shoqerise, ne pajtim me nenin 13 te Ligjt 9901, deri ne momentin kur ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, te gjithe anetaret kane rene dakord qe:

- te autorizojne lidhjen e kesaj marreveshje dhe
- te autorizojne kete anetar qe te votoje ne lidhje me kete ceshtje.

Autorizimi mund te jete i pergiithshem ose i posacem per nje ceshtje te caktuar. Autorizimi i per gjithshem duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

(2) Vota e Administratorit nuk do te llogaritet ne kuorumin e pjesemarresve ne mbledhje ne lidhje me vendimin per te cilin ky anetar nuk ka te drejte te votoje. Dispozitat e nenit 89 te Ligjt "Per tregtatert dhe shoqerite tregtare" do te zbatohen lidhur me perjashtimin e Administratorit nga vendimet e marra ne kete mbledhje.

(3) Ne rast se ne mbledhjen e Administratoreve ose te komitetit te Administratoreve diskutohet nje ceshtje e lidhur me te drejten e votes se nje Administratori, ceshtja mund ti drejtohet Kryetarit te mbledhjes, perpara perfundimit te mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me cdo Administrator te ndryshem nga ai vete do te jete perfundimtar dhe i formes se prere.

Neni 25:

Procesverbalet e Mbledhjeve te Administratoreve

Administratoret kujdesen qe ne libra te posacem te mbahen procesverbalet e:

- I. te gjitha takimeve te kryera nga Administratoret; dhe
- 2.te gjitha mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme, mbledhjeve te Adininistratoreve dhe komiteteteve te Administratoreve, pérfsfiré edhe emrat e Administratoréve te pranishém nö kétó mbledhje.

Kreu V

Dividendet dhe Kalimi i Fitimeve ne Kapitalin Themeltar

Neni 26:

Dividendet

(1) Pas plotësimit të parashikimeve te Nenit 77 te Ligiit 9901, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

(2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhën në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhën në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

(3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

Neni 27: Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit 9901, mund të vendosin te kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Kreu VI

Prishja dhe njoftimet

Neni 28: Prishja dhe likuidimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- q) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
- d) me vendim të gjykatës;

Prishja e shoqërise tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për

procedurën e zakonshme të likuidimit në giendjen e aftësisë paguesejane Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901.

Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me Nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Neni 29: Njoftimet

(1) Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

(2) Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzetërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

(3) Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të shoqërisë, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të këtij Statuti (nëse zbatohet).

Emrat dhe nënshkrimet e Ortakëve Themelues:

- Bianka Ferruku

Bianka Ferruku



Tirane me 30/10/2020